

Mbrojtja e Liqenit të Ohrit

“DREJT NJË QEVERISJEJE TE PËRBASHKËT TË TRASHËGIMISË NATYRORE DHE KULTURORE NDËRKUFITARE TË RAJONIT TË LIQENIT TË OHRIT”

NË KETË NUMËR

- 1 Parathënie nga Ministri shqiptar i Mjedisit (faqe 1)
- 2 Rreth projektit (faqe 2)
- 3 Pikat kyçe të projektit (faqe 3)
- 4 Takimet e projektit (faqe 3)
- 5 Intervistë me Kryetarin e Bashkisë Pogradec (faqe 4)
- 6 Lajme rreth rajonit të Liqenit të Ohrit (faqe 4)
- 7 Turizmi rreth rajonit të Liqenit të Ohrit (faqe 5)
- 8 Aktivitetet e ardhshme-kalendar (faqe 6)
- 9 Partnerët (faqe 6)

“ Dy të tretat e Liqenit të Ohrit, pjesa maqedonase, është përfshirë në Listën e Trashëgimisë Botërore si një pasuri mikse natyrore dhe kulturore. Tashmë ka ardhur koha që të zgjerohet statusi i kësaj pasurie botërore edhe me 1/3 e pjesës shqiptare të Liqenit të Ohrit ”

Të dashur lexues!

Është kënaqësi t'ju drejtohem në këtë numër të parë të Gazetës së projektit ndërkufitar që ndërthur mbrojtjen e elementeve të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të rajonit të Liqenit të Ohrit.

Çështja e menaxhimit të qëndrueshëm të Zonave të Mbrojtura është sot një drejtim kryesor i punës së Ministrisë së Mjedisit dhe mbetet një sfidë për arritjen e rezultateve të prekshme dhe të matshme të komponenteve të biodiversitetit si një proces që realizon mbrojtjen dhe në të njëjtën kohë përdorimin e qëndrueshëm të hot-spotëve të biodiversitetit, habitateve dhe llojeve.

Fillimi i zbatimit të këtij projekti ndërkufitar është një kontribut, në kontekstin e menaxhimit të integruar të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të këtij rajoni me rëndësi të veçantë për natyrën dhe biodiversitetin.

Rajoni i Liqenit të Ohrit ka një status të shumëfishtë si Peizazh i Mbrojtur dhe përfshihet në Rezervën e Biosferës ndërkufitare për Shqipërinë dhe Ish republikën Jugosllave të Maqedonisë.

Projekti synon të adresojë kërcënimet që ndikojnë në trashëgiminë natyrore dhe kulturore të rajonit të Liqenit të Ohrit në kuadër ndërkufitar midis Shqipërisë dhe Ish republikën Jugosllave të Maqedonisë.

Forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar për trashëgiminë kulturore dhe natyrore të rajonit, ndihma për të promovuar vlerat e kësaj zone; identifikimi i karakteristikave të saj, evidentimi i mundësive për një zhvillim të qëndrueshëm, përmirësimi i kapaciteteve për menaxhimin efektiv të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, planifikimi i menaxhimit të integruar bazuar në bashkëpunimin aktiv ndërsektorial dhe pjesëmarrjen e publikut, do të jenë shtyllat kryesore gjatë zbatimit të projektit.

Projekti mbështet procesin e zgjerimit të pasurisë së “Trashëgimisë Botërore dhe natyrore e Rajonit të Liqenit të Ohrit” në Shqipëri – pas njohjes së pjesës maqedonase të Liqenit të Ohrit si trashëgimi botërore.

Përgatitja e dosjes së nominimit të rajonit të Liqenit të Ohrit për në UNESCO si dhe e Planit të Menaxhimit të saj do të kontribuojë në ruajtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të zonës, duke siguruar, bashkëpunuar dhe shkëmbyer eksperiencën në kontekst ndërkufitar.

Në këtë mënyrë, Liqeni i Ohrit do të marrë vizibilitetin e duhur për t'u promovuar si një zonë me vlera natyrore dhe kulturore për turistë vendas dhe të huaj.

Përzemërsisht,

Lefter Koka

Ministër i Mjedisit



Faktet kryesore

Trashëgimi botërore që nga 1979

- **1979** Liqeni i Ohrit është regjistruar për herë të parë në Listën e trashëgimisë botërore si pasuri natyrore (sipas kriterit iii), si një fenomen superlativ natyror, që është sot kriteri (vii)
- **1980** Pasuria e trashëgimisë botërore u shtri dhe sipas kriterit kulturor (i), (iii) dhe (iv) dhe u bë një nga pasuritë e para mikse të trashëgimisë botërore.
- **1998** Një mision monitorues i përbashkët UNESCO-ICOMOS- IUCN u krye për herë të parë që nga listimi i kësaj trashëgimie. Misioni theksoi se zhvillimet ekonomike dhe demografike përbëjnë kërcënim për vlerat e këtij rajoni, të cilat mund të adresohen përmes një qëndrimi të integruar dhe masave mbrojtëse që lidhen me ruajtjen e kësaj trashëgimie kulturore dhe natyrore. Statusi i ruajtjes së kësaj pasurie u diskutua dhe nga Byroja e Trashëgimisë Botërore në Kyoto, Japoni. (Vendimi 22, Com VII.30)
- **2008** Në sesionin e 32 të saj (Quebec City 2008), Komiteti i Pasurisë Botërore nisi ‘Procesin Upstream’, si një reflektim për të ardhmen e kësaj trashëgimie kulturore. Ky proces është një qasje eksperimentale që ka synim të reduktojë një numër terriore që pësojnë ndryshime thelbësore gjatë procesit të kandidimit për t’u futur në listën e trashëgimisë botërore.
- **2009** Komiteti i Trashëgimisë Botërore miratoi një modifikim të kufirit minimal duke reduktuar disi kufijtë veriorë dhe perëndimorë të kësaj pasurie. Brenda këtij procesi ‘Upstream’, Komiteti inkurajon krijimin e zonës së mbrojtur, si dhe marrjen e masave drejt një zgjerimi ndërkufitar të Pasurisë së Trashëgimisë Botërore, e cila duhet të përfshijë dhe pjesën shqiptare të Liqenit të Ohrit.
- **2011** Komiteti i trashëgimisë Botërore në vendimin 35 Com 12C. zgjodhi 10 projekte pilot për të testuar efektivitetin e Procesit ‘Upstream’, përfshi Projektin Pilot: “Trashëgimia Natyrore dhe Kulturore e Liqenit të Ohrit (Shqipëria dhe ish Republika Jugosllave e Maqedonisë).
- **2011** Shqipëria aplikon për pranimin e trashëgiminë kulturore dhe natyrore të rajonit të Ohrit në Listën Tentativë, si një hap i parë në procesin e zgjerimit të kësaj pasurie të Trashëgimisë Botërore.
- **2012** Faza e parë e Procesit Upstream përfshiu dërgimin e Misionit Këshillimor për të kryer një studim fizibiliteti të pjesës që do zgjerohet, e cila do përfshihet në listën e trashëgimisë. Misioni identifikoi kërcënime që preknin trashëgiminë kulturore dhe natyrore të Liqenit të Ohrit, si: zhvillimi urban i paplanifikuar, peshkimi dhe ndryshimi i habitateve, si dhe veprime të paqëndrueshme të menaxhimit të mbetjeve.
- **2014** Faza e dytë e projektit pilot inicioi një projekt të ri “Drejt forcimit të qeverisjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore të rajonit të përbashkët ndërkufitar të Liqenit të Ohrit”.

Projekti

Liqeni i Ohrit, një nga liqenet më të vjetër të botës, që ndodhet në Europën Juglindore, konsiderohet një nga rezervat më të mëdha të biodiversitetit dhe njëkohësisht një nga vendbanimet më të vjetra njerëzore në kontinent. Kombinimi i vlerave të dukshme natyrore, me cilësinë dhe diversitetin e trashëgimisë kulturore, materiale dhe shpirtërore e bëjnë këtë rajon vërtet unik.

Dy të tretat e Liqenit të Ohrit, pjesa maqedonase e Liqenit, është futur tashmë në Listën e Trashëgimisë botërore, si një pasuri mikse e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore e rajonit të Ohrit. Tashmë ka ardhur koha të bashkohen gjithë përpjekjet për të marrë përgjegjësitë tona dhe për ta shtrirë statusin e Trashëgimisë Botërore në pjesën e mbetur të Liqenit, një të treta, që ndodhet në territorin shqiptar.

Projekti “Drejt një qeverisjeje të përbashkët të trashëgimisë natyrore dhe kulturore ndërkufitare të rajonit të Liqenit të Ohrit”, është projektuar për të adresuar të gjithë faktorët kryesore që prekin rajonin përmes identifikimit dhe ruajtjes së aseteve kryesore natyrore dhe kulturore të liqenit, si dhe përmirësimit të bashkëpunimit e menaxhimit ndërkufitar.

Përpjekjet e rajonit për të balancuar ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm janë përcaktuar në marrëveshjen dypalëshe të vitit 2005, të firmosur mes dy vendeve për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e qëndrueshëm të Liqenit të Ohrit dhe pellgut ujëmbledhës të tij. Projekti është i koordinuar nga UNESCO, në partneritet me autoritetet e dy vendeve dhe tre bordet këshillimore të Komitetit të Trashëgimisë botërore (ICOMOS, IUCN dhe ICCROM), financohet nga BE (1 700 000 euro) dhe nga Qeveria e Shqipërisë (170 000 euro).

Aktivitetet kryesore të Projektit përfshijnë:

- (i) përforsimi i bashkëpunimit ndërkufitar mes Shqipërisë dhe Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë;*
- (ii) Krijimi i mekanizmave të menaxhimit të integruar;*
- (iii) Ngritja e kapaciteteve për menaxhim efektiv;*

Aktivitetet gjithashtu kanë synim të identifikojnë dhe ruajnë asetet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, të sigurojnë ndihmën teknike për autoritetet kombëtare për përgatitjen e dosjes së zgjerimit të pasurisë ndërkufitare të Trashëgimisë botërore, dhe zbatimin e një fushate ndërgjegjësimi për menaxhimin e mbetjeve.

takimet e projektit

Seminare për planet e menaxhimit

SEMINARI I PARË për planet e menaxhimit për mbrojtjen e rajonit ndërkufitar të Liqenit të Ohrit, u zhvillua në 26 mars 2015 në Korçë, qytet në juglindje të Shqipërisë. Korça është qarku që gjithashtu përfshin qytetin e Pogradecit, i cili ndodhet në brigjet e Liqenit të Ohrit.

Seminari mbledhi së bashku autoritetet kombëtare dhe lokale të dy anëve të Liqenit dhe përfaqësues të UNESCO-s si dhe bordeve këshillimore të Komitetit të Trashëgimisë Botërore (ICCROM, ICOMOS dhe IUCN).

Pjesëmarrësit diskutuan sistemet e menaxhimit të trashëgimisë që përdoren aktualisht në rajon dhe identifikuan grupet kryesore të interesit që do të mbështesin zhvillimin e planit për menaxhimin e trashëgimisë ndërkufitare.

Në takim, grupet e interesit prezantuan gjendjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në rajonin e Liqenit të Ohrit, duke u fokusuar në strukturat ekzistuese të menaxhimit dhe planifikimit të proceseve në këtë rajon.

Pjesëmarrësit u ndanë në dy sesione pune: sesioni i parë u morr me një tematikë bazuar në temat kyçe të projektit (mbetjet, turizmi i qëndrueshëm, zivillimi urban, planifikimi hapësinor, shoqëria civile dhe komunitetet); ndërsa sesioni i dytë përfshiu grupin e punës me fokus natyrën dhe kulturën.

Kompozimi miks dhe përmasat e grupeve mundësuan dialogun përmes sektorëve të ndryshëm dhe një rishikim më të integruar të grupeve të interesit që janë prezent në rajonin e Liqenit të Ohrit.



Seminari i parë, Korçë

SEMINARI I DYTË për planet e menaxhimit u mbajt në datat 3 dhe 4 Qershor 2015 në Tiranë, Shqipëri. Ky takim mbledhi së bashku grupet e interesit nga dy anët e Liqenit për të diskutuar mbi një vizion afatgjatë dhe objektivat e menaxhimit për mbrojtjen e një zone potenciale ndërkufitare të Liqenit të Ohrit. Një numër pjesëmarrësish nga institucione të ndryshme ndoqën këtë seminar, ku u përgatitën bashkërisht katër deklarata mbi vizionin

e menaxhimit të Liqenit në kuadrin e projektit të zgjerimit të trashëgimisë botërore. Katër deklaratat u shkruanë në një të vetme, e cila do të përmirësohet gjatë procesit të planeve të menaxhimit për projektin e zgjerimit të Trashëgimisë Botërore. Ky seminar gjithashtu u fokusua në përcaktimin e hartave, përmirësimin e njohurive për këtë rajon dhe kuptimin e faktorëve të ndryshëm që prekin këtë zonë, në veçanti projektet aktuale dhe ato të së ardhmes, si dhe iniciativat që mund të kenë një ndikim në rajonin e Liqenit të Ohrit dhe pasurisë potenciale ndërkufitare të Trashëgimisë Botërore.



Seminari i 2-të, në Tiranë

SEMINARI I TRETË për planet e menaxhimit dhe trajnimi tematik për rajonin e Liqenit të Ohrit u mbajt në Pogradec, Shqipëri nga 7-10 dhjetor 2015. Ky seminar i dha një shtysë punës së bërë për një sistem të integruar menaxhimi për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit të Liqenit të Ohrit. Theksi i seminarit për planet e menaxhimit u vu tek vizioni afatgjatë, diskutimi i kufijve dhe zonës së mbrojtur, dhe identifikimi i objektivave të menaxhimit për rajonin e Liqenit të Ohrit në kuadrin e zgjerimit potencial të pasurisë së trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore të rajonit të Liqenit të Ohrit, në Shqipëri. Përfaqësuesit e dy vendeve morën pjesë në këtë seminar, përfshi dhe autoritetet kombëtare nga ministratë respektive të Mjedisit dhe Kulturës, autoritetet lokale nga bashkitë rreth rajonit të Liqenit të Ohrit, Bordet këshillimore të Komitetit të Trashëgimisë Botërore (ICCROM, ICOMOS dhe IUCN) si dhe përfaqësues nga UNESCO.



Seminari i 3-të në Pogradec



Takimet e Platformës Ndërkufitare

Takimi i parë i mbajtur në Shqipëri në shtator 2014, startoi dhe iniciativën tre-vjeçare për mbrojtjen e Liqenit të Ohrit, duke shërbyer kështu si takimi i parë i platformës ndërkufitare për të përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë.

Takimi i dytë i platformës ndërkufitare u zhvillua në 2 tetor 2015, në qytetin e Ohrit, duke ndjekur të njëjtat hapa. Këto 2 takime janë pjesë e gjashtë takimeve gjithsej që zhvillohen në kuadër të këtij projekti, të cilat kanë synim të mbështesin Qeverinë Shqiptare dhe Maqedonase në përpjekjet e tyre për të mbrojtur zonën e Liqenit të Ohrit, si dhe të krijojnë struktura ndërkufitare për menaxhimin efektiv të trashëgimisë. Një numër përfaqësuesish nga Ministratë e Mjedisit dhe Kulturës të dy vendeve, si dhe nga bashkitë e rajonit ndoqën takimin e platformës ndërkufitare, përfshi ekspertë nga UNESCO dhe Bordet Këshillimore të Trashëgimisë Botërore (ICOMOS dhe IUCN). Takimi i Platformës Ndërkufitare ka qëllim të përmirësojë dhe lehtësojë bashkëpunimin dypalësh mes përfaqësuesve të administratave lokale dhe qendrore të dy vendeve Shqipërisë dhe ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, sektorit të turizmit dhe autoriteteve përgjegjëse për zhvillimin rural dhe urban, kulturën, mbrojtjen e natyrës, menaxhimin të burimeve ujore dhe mjedisit. Takimi adresoi faktorët kryesorë që ndikojnë në trashëgiminë natyrore dhe kulturore të rajonit të liqenit të Ohrit, kryesisht zhvillimin urban, menaxhimin e mbetjeve, ndryshimin e habitateve dhe shkatërrimin apo zhdukjen e burimeve natyrore.

ARRITJE - U publikua në muajin Mars **draft-raporti i Vlerësimit Bazë** i përgatitur në bashkëpunim me ICOMOS dhe IUCN-ECARO. Ky raport paraqet një informacion thelbësor të rajonit të Liqenit të Ohrit në Shqipëri që mbulon një sërë temash si: biodiversiteti, bujqësia, pyjet, trashëgimia direkte dhe indirekte, si dhe turizmi. Ky raport ishte i hapur për diskutime me publikun nga data 16 shkurt deri 18 mars 2016.

Intervistë me Kryebashkiakun e Pogradecit z. Eduard Kapri për të diskutuar përgjegjësitë dhe përfitimet e përbashkëta të projektit



Kryetari i Bashkisë Pogradec, z. Eduard Kapri

Çfarë do të thotë për Pogradecin projekti: “Drejt një qeverisjeje të përbashkët të trashëgimisë natyrore dhe kulturore ndërkufitare të rajonit të Liqenit të Ohrit”

Z. Kapri: Projekti: “Drejt një qeverisjeje të përbashkët të trashëgimisë natyrore dhe kulturore ndërkufitare të rajonit të Liqenit të Ohrit” e ka filluesën në Marrëveshjen bilaterale ndërmjet dy qeverive për mbrojtjen e Liqenit të Ohrit në vitin 2005. Kjo marrëveshje ka qëllim që për basenin e liqenit të Ohrit. Shqipëria dhe ish Republika Jugosllave e Maqedonisë të realizojnë plane të përbashkëta për zhvillimin urban, rregullimin e territorit, përdorimin e tokës, për të siguruar administrimin e saj sipas parimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së Liqenit të Ohrit dhe pellgut të tij ujëmbledhës. Një Komitet i përbashkët dështetesh, po përipiqet të vendosë kriteret, standarde, kufij dhe objektiva të sakta për mbrojtjen, ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të pellgut ujëmbledhës të Liqenit të Ohrit në zbatim të normave të BE për mjedisin. Shpresoj që edhe ky projekt të japë kontributin e tij në këtë drejtim.

Çfarë hapash po ndërmerr Bashkia e Pogradecit për mbrojtjen dhe ruajtjen e Liqenit të Ohrit?

Z. Kapri: Bashkia Pogradec sipas ndarjes së re administrative është e vetmja njësi e qeverisjes vendore që mbulon pjesën shqiptare të basenit të liqenit të Ohrit. Ky fakt përbën një avantazh lidhur me menaxhimin e vijës breg-liqenore pasi plani për zhvillimin urban, rregullimin e territorit, apo përdorimin e tokës, administrohet vetëm nga një njësi administrative. Aktualisht, Bashkia është duke përgatitur Planin e Përgjithshëm Vendor, (PPV), si pjesë e 26 bashkive të përzgjedhura për t’u asistuar nga Qeveria, me asistencë financiare dhe teknike në hartimin e tyre. Pjesë integrale e PPV do të jenë edhe elementët që kanë të bëjnë me Trashëgiminë Kulturore dhe Natyrore për pjesën shqiptare e pellgut ujëmbledhës të Liqenit të Ohrit, masat për ruajtjen e tyre si dhe disiplinimin e faktorëve që kanë impakt negativ mbi liqenin e Ohrit, cilësinë e ujit, florën dhe faunën e tij.

Cili është plani i Bashkisë për zhvillimin turistik rreth zonës. Do ketë ndërtime rreth liqenit?

Z. Kapri: Bashkia Pogradec e shikon zhvillimin turistik të zonës si një nga prioritetet e zhvillimit ekonomik të saj, duke e fokusuar atë në konceptin e turizmit alternativ për ta bërë rajonin e pjesës shqiptare të basenit të liqenit të Ohrit atraktiv, jo vetëm në periudhën e sezonit të verës, por përgjatë 12 muajve të vitit. Bashkia Pogradec ka resurse turistike të shumta të cilat kërkojnë një konceptim dhe menaxhim ndryshe, për t’u bërë burim të ardhurash për komunitetin.

Si mund të përfshini, ndërgjegjësoni komunitetin e Pogradecit për të ruajtur vlerat e Liqenit të Ohrit?

Z. Kapri: Pogradeci trashëgon një traditë qytetare lidhur me “detyrimin” për të mbrojtur liqenin e Ohrit. Gjatë gjithë historisë së tij uji i liqenit është trajtuar si një dhuratë e shenjtë e dhënë nga Zoti dhe tani jetesa e njerëzve në pellgun ujëmbledhës varet nga mundësitë e ndryshme të përdorimit që ofron liqeni, duke filluar nga uji i pijshëm e argëtimit, deri te peizazhi, puna kërkimore-shkencore, peshkimi, bujqësia, turizmi etj. Përveç kësaj, në kuadër të Projektit për Ruajtjen e Liqenit të Ohrit, të zbatuar në periudhën 1996-2004, u krijua një rrjet i OJF-ve mjedisore lokale për sensibilizimin e shtresave të ndryshme të shoqërisë dhe rritjen e kontributit e tyre në çdo vendim-marrje të rëndësishme për rajonin. Ne gjithashtu e konsiderojmë shumë të domosdoshëm bashkëpunimin ndërkufitar. Së bashku me Bashkitë e Strugës dhe Ohrit ne firmosëm një Memorandum Mirëkuptimi në Vismar të Gjermanisë dhe një tjetër memorandum për bashkëpunimin teknik do të firmoset në Ohër. Kjo është e vetmja mënyrë për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të Liqenit frymëzuar nga motoja “një liqen, një vizion, një e ardhme”.



Pamje nga puajt shqiptare

Parlamenti shqiptar miratoi një moratorium 10 vjeçar për të ruajtur puajt

Parlamenti shqiptar ka miratur një moratorium 10 vjeçar për ndalimin e prerjes së pemëve për qëllimet industriale dhe eksport. Ligji i përgatitur nga Ministria e Mjedisit lejon autoritetet lokale të miratojnë vetëm prerje të kufizuara të drurëve për ngrohje. Një sipërfaqe prej 1.4 milionë hektarë pyje është dëmtuar rëndë ose është djegur gjatë 26 viteve që nga rënia e regjimit komunist, me një mesatare prej 2.5 mln pemë të prera çdo vit. Ministri shqiptar i Mjedisit Lefter Koka u shpreh se ky vendim radikal u morr pasi dështuan gjithë masat për të ndaluar prerjen e pemëve, një fenomen që gjithashtu ka kontribuar në përmbytjet që vendi ka pësuar në vitet e fundit.

Varka e vjetër, tregon historinë e jetës në Ohër

Një varkë e vjetër, e rikonstruktuar së fundi, riktheu kujtime të largëta të qytetarëve që jetonin dikur në brigjet e Liqenit të Ohrit. Kjo varkë u shtua si një atraksion për turistët vendas dhe të huaj në një shtëpi të Robevcit në Ohër. Idea për ta rindërtuar këtë varkë ishte e Goran Patchev, një aritekt i Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës dhe Muzeut të Ohrit. Kjo lloj varke e vjetër ishte një pjesë e pandarë e jetës së qytetarëve që jetonin rreth Liqenit të Ohrit. Ajo shërbente për peshkim, për transport të njerëzve dhe postës nga Ohri, Pogradeci, Struga, Shën Naumi dhe Lini si dhe për transportimin e të mirave, druve, gurit, rrushit, rërës etj si dhe për festime dhe ceremoni që mbaheshin rreth Liqenit.



Varka e vjetër & Goran Patchev

I pyetur nëse varka do të mbetet si një ekspozitë në Muzeun e Robevcit apo do të lundronte sërish në ujërat e Liqenit, Z. Patchev u përgjigj: Qëllimi i rikonstruksionit të varkës u arrit. Ajo tashmë risjell kujtimet e varkës së vjetër të Ohrit. Por ne shkuam më tej, dhe bëmë një provë lundrimi për të vërtetuar që ajo mund të përdoret edhe për qëllime turizmi, për koktejlje, për evente të ndryshme si një atraksion turistik. Me disa përmirësime në materiale dhe në prodhim, ajo sërish mund të kthehet në një mjet të zakonshëm lundrimi në liqen. Kjo varkë do të mbetet si një ekspozitë në oborrin e shtëpisë së Robevcit dhe të japë një leksion të historisë së jetës në këtë zonë.

Shqipëria përcakton zonën e mbrojtur të Bazilikës, Lin Pogradec

Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në varësi të Ministrisë së Kulturës, miratoi zonën e mbrojtur të “Rrënojave të Kishës Paleokristiane dhe Mozaikët”, në fshatin Lin,



Mozaiku i Linit, Pogradec

Pogradec. Zona e mbrojtur përfshin “Rrënojat e Kishës Paleokristiane dhe Mozaikët”, e konsideruar si Monument i Kategorisë I. Bazilika Paleokristiane e Linit ndodhet në pjesën perëndimore të Kepit të Lin-it dhe përfaqëson një nga monumentet më të rëndësishme të trashëgimisë së Shqipërisë. Struktura është e dekoruar me mozaikë shumëngjyrësh me motive floreale, gjeometrike dhe skena eukaristike, tipike të periudhës paleokristiane. Gërmimet arkeologjike dhe të dhënat numizmatike mbështesin datimin e bazilikës dhe të dyshemesë me mozaik në shek. V – VI. Mozaikët polikrom dhe materiali i pasur arkeologjik, e bëjnë kishën të cilësohet si një nga monumentet më të bukura dhe më interesante në territorin e Shqipërisë.

QYTETI I OHRIT, PERLA E BALLKANIT

I ndodhur në brigjet e Liqenit të Ohrit, qyteti i Ohrit është një nga vendbanimet më të vjetra në Europë. Qyteti i Ohrit, pjesa më e madhe e të cilit shtrihet në rajonin e Liqenit, mbetet destinacioni kryesor turistik në gjithë ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë; me lagjen e vjetër të qytetit ku ndodhen kishat e bukura përgjatë një kodre të magjishme, në krye të së cilës është një kështjellë mesjetare, nga e cila mund të shihet deri 34 km gjatësi e Liqenit të Ohrit. Ky qytet padyshim është atraksioni më i bukur i rajonit të Liqenit të Ohrit.

Trashëgimia kulturore

I ndërtuar mes shekujve të 7 dhe 19, qyteti i Ohrit është shtëpia e një prej manastireve më të vjetra sllave (Sen Pantelejmon) me më shumë se 800 ikona bizantine, që datojnë nga shekulli i 11 dhe fundi i shekullit të 14.

Koleksioni i ikonave konsiderohet një nga më të rëndësishmit në botë. Qyteti i Ohrit ka gjithashtu një nga komplekset arkeologjike të ruajtura më mirë në të gjithë Europën, me rrënoja që datojnë që nga Epoka e Bronzit deri në Mesjetë. Ohri ka një arkitekturë fetare që daton që nga shek i 7 deri në 19 si dhe strukturë urbane që përfaqëson arkitekturën moderne të shek 18 dhe 19. Gjithë këto pasuri paraqesin një thesar me vlera historike, arkitektuale, kulturore dhe artistike.

Çfarë të shihni?

Gjithë atraksionet e Ohrit ndodhen brenda një zone jashtëzakonisht të përqendruar dhe të aksesueshme nga të gjitha anët. Rrugët e ngushta të qytetit të vjetër, të mbushura anës tyre me restorante dhe kafene janë përshtatur në mënyre perfekte për t'u relaksuar përkundrejt ose përgjatë liqenit. Atraksionet kryesore të qytetit përfshijnë: Shën Jovan Kaneo, Shën Naum, Manastiri i Galicicias, Parku kombëtar i kështjellës Car Samuel, Kisha e Shën Sofisë, Manastiri i Shën Klimentit, Kisha e Plaoshnikut etj.

Çfarë të bëni?

Kafenetë e shumta, klubet e natës e bëjnë jetën e vonë të vloyë në këtë qytet. Sa për liqenin, ai është aq i madh dhe aq i thellë sa shumë njerëzve u duket si det. Pasionantët e sporteve të ujit mund të shijojnë peshkimin apo lundrimin. Një numër kishash përgjatë brigjeve të liqenit mundësojnë udhëtime dhe ecje fantastike buzë tij, ndërsa turistët e natyrës dhe aventurës mund të eksplorojnë Parkun Kombëtar të Galicicias, një vend ideal një bukuri të egër e të virgjër. Gjithashtu mund të bëni një shëtitje të këndshme përgjatë brigjeve të liqenit të Ohrit; mund të pini një kafe, një gotë verë ose të hani një vakt duke shijuar pamjen nga liqeni. Ohri dhe plazhet janë të mbushura plot nga 15 korriku-15 gusht, sidomos gjatë festivalit popullor të verës kur duket se gjysma e gjithë popullsisë zbrit në qytet. Baret dhe restorantet janë plot gjatë verës, ndërsa në qershor ose shtator janë më të qeta, duke u dhënë mundësi vendasve dhe turistëve të meditojnë buzë liqenit.

POGRADECI, NË HARMONI ME NATYRËN

Pogradeci është një nga destinacionet më tërheqëse turistike në Shqipëri, i vendosur në brigjet e Liqenit të Ohrit. Udhëtimi në Pogradec është gjithnjë frymëzues. Sa më shumë e vizitoni, aq më shumë dashuroheni me qytetin. Duke udhëtuar në Qafë Thanë, sapo arrini në majë dhe filloni të zbrisni poshtë drejt Liqenit të Ohrit shfaqet fshati Lin me pamjen e mrekullueshme, i rrethuar nga kodrat duke e zbuluar veten si një libër për sytë e turistëve. Bukuria dhe qetësia e liqenit të gjallërojnë shpirtin. Sapo hyn në qytet, një shëtitore e gjatë të fton për një ecje buzë liqenit. Pogradeci është shumë mikpritës dhe njerëzit janë nga më miqësorët në Shqipëri, pasi liqeni i ka zbutur zemrat e tyre. Ky qytet është vendlindja e shumë shkrimtarëve dhe poetëve të famshëm: Lasgush Poradeci dhe Mitrush Kuteli, Luan Starova, piktorëve Anastas Kostandini (Taso), Gjergji Lako, Gentian Zeka, Vangjo Vasili dhe Ilir Dhima.

Trashëgimia kulturore

Në pjesën perëndimore të Gadishullit të Linit, ju mund të vizitoni Kishën palekristiane, një monument Kulturor Kombëtar i Shqipërisë, i përfshirë rreth perimetrit të zonës në Listën Tentative të UNESCO-s për trashëgiminë kulturore dhe natyrore të rajonit të Liqenit të Ohrit-Shqipëri. Varret ilire të Selcës së Poshtme, 40 km nga Pogradeci janë një tjetër destinacion i rëndësishëm për t'u vizituar. Varret ndodhen mes rrënojave të qytetit të lashtë Pelion, një vendbanim iliri i fisit Enchele dhe residenca e mbretërve ilirë. Në 1996 Shqipëria propozoi që varret mbretërore të Selcës së Poshtme të nominohen në Listën Tentativë të Trashëgimisë Botërore të UNESCO. Të tjerë vende arkeologjike përfshijnë kishat e tjera për t'u vizituar si: kisha e Shën Dimitrit (kishë e vogël ortodokse, 1154 AD) dhe kisha Shën Marena (kishë ortodokse e ndërtuar në 1744).

Çfarë të shihni?

Fshati Lin dhe mozaiku janë stacioni i parë në rrugën për Pogradec. Fshati ndodhet në një gjë të qetë dhe piktoresk me shtëpi të bukura dhe çati të kuqe.

Parku kombëtar i Drilonit, gjithashtu është një

*"Liqeni i shkretëtë e rrit tallazin porsi det
E shpirtin duke më përcjellë më thotë
Ah! Shih sa është i thellë
Ky gjiri em që të patë pjellë"*

Lasgush Poradeci



vend i rëndësishëm për t'u vizituar në Pogradec me burime të pastra uji kristal që furnizojnë kanalet e bukura të mbuluara nga pemë dhe bimë kacavjerrese. Kjo ka qenë shtëpia e pushimit e ish diktatorit Enver Hoxha, vila e të cilit tashmë është hotel dhe restorant.

Fshati Tushemisht dhe qendra e tij e rinovuar se fundi nuk duhet humbur. Blogeri Yomadic e quan atë "Venecian" e vogël shqiptare të mbushur plot me kanale me ujëra të pastra që burojnë nga mali që për ironi quhet "Mali i thatë". Një tjetër ngjarje e rëndësishme mbetet **Festivali Ballkanik i Filmit dhe Kulinarisë**, i cili konsiderohet një event i madh për jetën kulturore të Pogradecit por edhe të Ballkanit.

Çfarë të bëni?

Pogradeci është perfekt për pushime të qeta. Muajt e pikut janë korriku dhe gushti ku bregu i Liqenit mbushet me adhuruesit e plazheve. Varka me pedale gjenden gjithandej, dhe po ashtu aktivitetet e 'canoeing' dhe 'kayaking' janë bërë shumë popullore. Jashtë sezonit qyteti kthehet në qetësi dhe është ideal për shëtitje dhe meditim. Në dimër skenat e liqenit janë panoramike, shpesh spektakolare, me borën që mbulon malet, të rrethuar sipër dhe poshtë me një ngjyrë blu dhe jeshil. Një nga gjerat pikante të Pogradecit është dhe kuzhina e shijshme dhe mrekullueshme.



Foto Ardian Fezollari



partneret Kush bën, çfarë?



UNESCO
Qendra e Trashëgimisë Botërore-koordinatore e Projektit



**Bashkimi Europian-
Kontribuesi Kryesor Financiar**



**Ministria e Mjedisit
e Republikës së Shqipërisë**



**Ministria e Kulturës
e Republikës së Shqipërisë**



**Ministria e Kulturës e ish
Republikës Jugosllave të Maqedonisë**



**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Fizik
të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë**



ICCRUM
**(Qendra Ndërkombëtare për Studimin e
Ruajtjes dhe restaurimit të Pasurisë Kulturore)**



ICOMOS
**(Këshilli Ndërkombëtar mbi Monumentet dhe
Vendet)**



IUCN
(Unioni Ndërkombëtar për ruajtjen e Natyrës)

Kalendari

Aktivitetet e ardhshme

- 9- 11 Maj 2016 Trajnimi mbi promovimin e Trashëgimisë Botërore në rajonin e Liqenit të Ohrit
- 11- 13 maj 2016 Takimi i 4-t për planet e Menaxhimit të Rajonit të Liqenit të Ohrit (Pogradec)
- 22 maj - 5 qershor 2016 Festivali Shqiptar i filmit Mjedisor
- 21 qershor 2016 Dita e Liqenit të Ohrit
- 22- 23 June 2016 Takimi i 5 për planet e Menaxhimit të Rajonit të Liqenit të Ohrit (Pogradec)
- 1 -7 qusht 2016 Festivali Ballkanik i Filmit dhe Kulinarisë
- 4-13 tetor 2016 -Kurs për qasjen ndaj Komunitetit Rajonal
- Nentor 2016 -Trajnim mbi ruajtjen dhe Menaxhimin e ekosistemit të Rajonit të Liqenit të Ohrit
- Dhjetor 2016- Trajnim për zhvillimin e një sipërmarrjeje të qëndrueshme

Të Mbrojmë Liqenin e Ohrit

*Kjo është një gazetë e publikuar nga Projekti :Drejt një qeverisjeje të përbashkët të trashëgimisë natyrore dhe kulturore ndërkufitare të rajonit të Liqenit të Ohrit.
Gjuhët: Anglisht, Shqip, Maqedonisht.*

Në numrin tjetër: Turizmi në Strugë dhe Debarca, Fushata e ndërgjegjësimit për mbejjet; rezultatet e konkursit të Fotove etj .

Faqja e projektit: <http://whc.unesco.org/en/lake-ohrid-region>
Twitter: https://twitter.com/lake_ohrid
Facebook: <https://www.facebook.com/LakeOhridHeritage/>
Blog: <http://lakeohrid.blogspot.al/>

Per komente/suggjerime email: a.fiebig@unesco.org
Copyright: UNESCO